



AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

M A T U R A S H T E T Ë R O R E 2 0 1 6

RAPORT PUBLIK

MBI

ARRITJET E NXËNËSVE

TIRANË, Nëntor 2016

Përmbajtja

	<i>Hyrje</i>	3
	<i>Metodologjia</i>	4
I	Lënda: Letërsi dhe Gjuhë Shqipe	7
1	<i>Arritjet e Nxënësve</i>	7
2	<i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe</i>	19
3	<i>Arritjet e nxënësve në Letërsi dhe Gjuhë Shqipe - statistika krahasuese</i>	22
II	Lënda: Matematikë	29
1	<i>Arritjet e Nxënësve</i>	29
2	<i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Matematikës</i>	41
3	<i>Arritjet e nxënësve në Matematikë - statistika krahasuese</i>	44
III	Lënda: Gjuhë e Huaj	51
1	<i>Arritjet e Nxënësve</i>	51
2	<i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës së Huaj</i>	64
3	<i>Arritjet e nxënësve në Gjuhën e Huaj - statistika krahasuese</i>	66
IV	Lëndët me Zgjedhje	73
1	<i>Arritjet e Nxënësve</i>	73
V	Renditja e shkollave	158

Hyrje

Hartimi i politikave arsimore ka si qëllim kryesor rritjen e perspektivave sociale dhe ekonomike të qytetarëve të saj, duke ndihmuar në mobilizimin e të gjitha burimeve, për të përmbushur kërkesat në rritje për një shkollim cilësor. Ajo çfarë ka më shumë rëndësi për njerëzit dhe ekonomitë tona janë aftësitë e fituara nëpërmjet edukimit. Njerëzit bëhen të suksesshëm dhe të qëndrueshëm në jetën e tyre profesionale dhe private nga kompetencat dhe cilësitë që ata zhvillojnë dhe marrin me anë të shkollimit, si dhe nga kualifikimet dhe kreditet e fituara.

Realizimi i këtij qëllimi kërkon ndërtimin e një sistemi efektiv dhe të barabartë arsimimi për të gjithë nxënësit e vendit, i cili mund të masë rezultatet aktuale të të nxënësve të fëmijëve dhe të rinjve në mosha dhe nivele të ndryshme arsimimi¹.

Raporti publik i Maturës Shtetërore 2016 synon të kontribuojë në zhvillimin dhe analizën e treguesve sasiorë krahasimorë të vlerësimit të jashtëm të arritjeve të nxënësve të maturës 2016.

Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që, mundëson jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel DAR/ZA, por njëkohësisht edhe krahasimin mes DAR/ZA, duke iu referuar edhe arritjeve në nivel kombëtar.

¹ OECD, Education at a glance 2016

Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e krijuar nga AKP gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2016. Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët letërsi dhe gjuhë shqipe, matematikë, gjuhë e huaj, si dhe lëndët me zgjedhje.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave të AKP janë:

- numri identifikues i nxënësit (ID),
- gjinia e nxënësit,
- DAR dhe ZA (së cilës i përket shkolla që ka frekuentuar nxënësi),
- lloji i shkollës (publike/private),
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet),
- profili i studimeve që ka ndjekur nxënësi (gjimnaz, gjimnaz gjuhësor, arsim profesional, social-artistik),
- sistemi i studimeve që ka ndjekur nxënësi (me kohë të plotë/me kohë të pjesshme),
- viti shkollor kur nxënësi ka mbaruar studimet e shkollës mesme,
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor,
- testet në provimet e maturës (që janë dhënë nga çdo nxënës),
- pikët e fituara në teste nga nxënësit,
- notat në provimet e maturës,
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor (për lëndët/testet e provimeve të maturës).

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve për testet e dhëna nga nxënësit në provimet e Maturës Shtetërore 2016 janë paraqitur:

- në nivel kombëtar,
- në nivel DAR,
- në nivel ZA,
- sipas urbanizimit - fshat/qytet,
- sipas gjinisë - femra/meshkuj,
- sipas profilit të shkollës që ka ndjekur nxënësi.

Në përpunimin statistikor të të dhënave janë përfshirë të dhënat e arritjeve **të nxënësve maturantë** të vitit shkollor 2015-2016, të cilët morën pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2016, sesioni i parë. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë numri i nxënësve sipas lëndëve/provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore 2016, sipas kategorive publik/privat, fshat/qytet, femra/meshkuj, arritjet e të cilëve janë përpunuar për përgatitjen e këtij raporti.

Nr.	Lënda e Provimit të detyruar	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Nr.	Lënda e Provimit të detyruar	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim		
		Total	Publik	Privat			Total	Publik	Privat
1	Letërsi	37338	32776	4562	1	Letërsi	37338	32776	4562
	Qytet	27630	23201	4429		Femra	19827	17454	2373
	Fshat	9708	9575	133		Meshkuj	17511	15322	2189
2	Matematikë	37248	32698	4550	2	Matematikë	37248	32698	4550
	Qytet	27556	23139	4417		Femra	19807	17434	2373
	Fshat	9692	9559	133		Meshkuj	17441	15264	2177
3	Gjuhë e Huaj	37319	32764	4555	3	Gjuhë e Huaj	37319	32764	4555
	Qytet	27606	23184	4422		Femra	19816	17445	2371
	Fshat	9713	9580	133		Meshkuj	17503	15319	2184

Përpunimi i të dhënave u realizua nëpërmjet software -ve Statistika dhe SPSS.

Informacioni statistikor i përftuar nga përpunimi është paraqitur në formë tabelore apo grafike.

Raporti përmban këta tregues statistikorë:

- Mesatarja e pikëve të fituara në testim,
- Nota mesatare Vjetore - (NV),
- Nota mesatare e Maturës - (NM),
- Shmangia standarde – (*shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*),
- Nota mesatare Vjetore në nivel kombëtar - (NVk),
- Nota mesatare e Maturës në nivel kombëtar - (NMk),
- Kalueshmëria në provimin e Maturës,
- Diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar - (NV – NVk),
- Diferenca e Notës së Maturës me Notën e Maturës në nivel kombëtar - (NM – NMk),
- Diferenca e Notës së Maturës me Notën Vjetore - (NM – NV).

Statistika përmbledhëse për MSH 2016

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për provimet e Maturës Shtetërore 2016 për sesionin e parë, si dhe të dy sesionet së bashku.

Në të dhënat e Lëndëve me Zgjedhje, numri i paraqitur përfaqëson numrin e nxënësve që i janë nënshtruar të dy lëndëve me zgjedhje si provim. Prandaj, shifra prej 73826 për sesionin e parë dhe 78460 për të dy sesionet së bashku, tregon se numri i nxënësve që kanë marrë pjesë në provimet e lëndëve me zgjedhje është 36913 për sesionin e parë dhe 39230 për të dy sesionet së bashku.

Numri i nxënësve në të dy sesionet së bashku është më i madh krahasuar me numrin e nxënësve në sesionin e parë, sepse në provimet e sesionit të dytë japin provim jo vetëm ata nxënës që kanë mbetur në sesionin e parë, por edhe ata nxënës, të cilët kanë qenë mbetës në dy lëndë vjetore në maturën 2016.


Dhënia e lëndëve/provimeve në sesionin e dytë, si nga nxënësit që kanë rezultuar mbetës në provimet e maturës, në sesionin e parë, po ashtu edhe nga nxënësit mbetës në jo më shumë se 2 lëndë vjetore, ndikon në rritjen e kalueshmërisë në përfundim të të gjithë procesit të Maturës Shtetërore 2016.

Nr.	Lënda e Provimit me zgjedhje	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në provimin e Maturës	Nota mesatare Vjetore
		Total	Publik	Privat	(në %)		
Sesioni i parë							
1	Letërsi	37338	32776	4562	98.46%	7.01	6.98
2	Matematikë	37248	32698	4550	89.71%	5.98	6.30
3	Gjuhë e Huaj	37319	32764	4555	98.44%	7.82	6.87
4	Lëndë me Zgjedhje	73826	64794	9032	96.31%	6.88	7.46
Të gjitha lëndët		185731	163032	22699	95.84%	6.92	7.00
Sesioni i parë dhe i dytë							
1	Letërsi	39010	34376	4634	99.20%	6.93	6.96
2	Matematikë	41992	37189	4803	97.17%	5.86	6.18
3	Gjuhë e Huaj	38998	34379	4619	99.78%	7.75	6.85
4	Lëndë me Zgjedhje	78460	69167	9293	99.01%	6.83	7.43
Të gjitha lëndët		198460	175111	23349	98.81%	6.84	6.96

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë Shqipe

1) Arritjet e Nxënësve

Grafikët e paraqitur në figurën e mëposhtme japin një informacion krahasues në nivel DAR/ZA të arritjeve të nxënësve në provimin e maturës, si dhe të arritjeve vjetore për lëndën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe. Grafikët e dhënë tregojnë përqindjet e nxënësve, njohuritë e të cilëve ndodhen në



intervalin “nën nivelin mesatar” dhe “mbi nivelin mesatar”. Si nivel mesatar është konsideruar kufiri mes notës shtatë dhe tetë. Për arritjet e maturës, në nivel kombëtar, përqindja e nxënësve që ndodhen nën nivelin mesatar” është 60% kundrejt 59.3% në arritjet vjetore. Ndërkohë, përqindja e nxënësve që ndodhen në mbi nivelin mesatar” është 40% për arritjet në provimin e maturës kundrejt 40.7% për arritjet vjetore. Figura tregon se, DAR/ZA Tepelenë, Peqin, Malësi e Madhe, Has dhe Gramsh kanë diferenca të theksuara mes arritjeve vjetore dhe arritjeve në provimin e maturës.

Tabela L – 1 jep informacion rreth arritjeve mesatare të nxënësve për lëndën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

I. Në nivel kombëtar:

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e maturës në lëndën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë është **26.62 pikë**, me shmangie mesatare 8.76;
- **nota mesatare e maturës** është 7.01 me shmangie mesatare 1.22;
- **nota mesatare vjetore** është 6.98 me shmangie mesatare 1.73.

Pra, në nivel kombëtar, nota mesatare e provimit të maturës (7.01) është pothuajse e barabartë me notën vjetore të nxënësve (6.98).

II. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën L-1, rezultojnë se:

- ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat.
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezultojnë të jetë rreth 3.3 pikë më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.
- ekzistenca e diferencës prej 3.3 pikësh në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston mes dy kategorive në notën mesatare të maturës, e cila arrin vlerën prej 0.7 njësi notë.

III. Arritjet sipas gjinisë

Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar, tregon se:

- vajzat kanë rezultate më të larta ndaj djemve.
- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, po ashtu edhe në sistemin privat.
- në nivel kombëtar, arritjet mesatare të vajzave të qytetit janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të vajzave të fshatit. Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e maturës për vajzat e qytetit është 4.49 pikë më e lartë kundrejt vajzave të fshatit.

Të njëjtën situatë kemi edhe për notën mesatare vjetore dhe notën mesatare në provimin e maturës, ku vajzat e qytetit kanë një notë mesatare prej 0.6 njësi note më të lartë.

Nëse shohim se si qëndrojnë arritjet e vajzave të qytetit kundrejt arritjeve të vajzave të fshatit për **sistemin publik**, rezulton përsëri e njëjta gjetje:

- vajzat e qytetit kanë arritje më të larta kundrejt arritjeve të vajzave të fshatit.

Ndërsa, **në sistemin privat**, rezulton gjetja:

- arritjet e vajzave të qytetit janë në nivele të njëjta me ato të fshatit.

Për **kategorinë e djemve**, të dhënat e Tabelës L-1, për nivelin kombëtar, tregojnë se:

- diferencat më të mëdha ekzistojnë mes djemve që kanë ndjekur shkollën në qytet me djemtë që e kanë ndjekur shkollën në fshat.

Në sistemin publik shihet se:

- arritjet e djemve në qytet janë më të larta kundrejt arritjeve të djemve të fshatit.

Në sistemin privat:

- djemtë e fshatit kanë arritje më të larta kundrejt djemve të qytetit.
- mesatarja e pikëve të fituara në provimin e maturës për djemtë e fshatit është 3.76 pikë më e lartë kundrejt djemve të qytetit.

IV. Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit.

Të dhënat e Tabelës L-1 tregojnë ekzistencën e diferencave mes arritjeve të nxënësve në dy sistemet arsimore publik e privat, në vendin tonë. Kështu:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik. Kjo gjetje qëndron si për mesataren e pikëve në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të maturës dhe atë vjetore.
- diferenca mes arritjeve të djemve të shkollave private me arritjet e djemve në shkollat publike (5.5 pikë) është më e madhe kundrejt diferencës së arritjeve të vajzave të shkollave private me ato publike (4.3 pikë). Pra, diferenca mes arritjeve të djemve (privat ndaj publikut) është rreth 1.2 pikë më e madhe kundrejt diferencës mes arritjeve të vajzave (privat ndaj publikut).

Nëse do të analizojmë **qëndrueshmërinë** e arritjeve të nxënësve në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore, shihet se:

- nxënësit e sistemit publik kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve krahasuar me nxënësit e sistemit privat. Kjo gjetje është e vlefshme edhe për kategoritë: femra e fshat.
- në sistemin privat, arritjet mesatare në provimin e maturës për vajzat janë rreth 0.73 njësi notë më të ulta kundrejt arritjeve mesatare vjetore të tyre, kur ndërkohë për vajzat e sistemit publik arritjet mesatare ndryshojnë me një vlerë prej 0.19 njësi notë kundrejt arritjeve vjetore.

Pra, qëndrueshmëria e arritjeve të nxënësve është më e lartë në sistemin publik kundrejt sistemit privat.

Tabela L-1

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Total	Femra	29.78	7.88	7.45	1.06	7.71	1.55
	Meshkuj	23.04	8.31	6.51	1.19	6.15	1.54
	Total	26.62	8.76	7.01	1.22	6.98	1.73
Qytet	Femra	30.96	7.71	7.61	1.03	7.84	1.53
	Meshkuj	24.17	8.42	6.67	1.19	6.30	1.57
	Total	27.76	8.74	7.17	1.20	7.12	1.73
Fshat	Femra	26.47	7.41	7.01	1.02	7.31	1.55
	Meshkuj	19.75	7.04	6.04	1.04	5.64	1.29
	Total	23.37	7.98	6.56	1.14	6.56	1.66
Publik total	Femra	29.26	7.87	7.38	1.07	7.57	1.54
	Meshkuj	22.35	8.12	6.42	1.17	5.95	1.43
	Total	26.03	8.70	6.93	1.21	6.82	1.70
Qytet	Femra	30.47	7.76	7.54	1.04	7.68	1.53
	Meshkuj	23.47	8.30	6.57	1.18	6.07	1.47
	Total	27.18	8.75	7.09	1.21	6.92	1.70
Fshat	Femra	26.38	7.38	6.99	1.02	7.29	1.55
	Meshkuj	19.59	6.92	6.02	1.03	5.62	1.26
	Total	23.25	7.93	6.55	1.13	6.54	1.65
Privat total	Femra	33.56	6.86	7.95	0.90	8.68	1.21
	Meshkuj	27.85	8.04	7.19	1.10	7.50	1.51
	Total	30.82	7.98	7.58	1.07	8.12	1.49
Qytet	Femra	33.57	6.88	7.95	0.91	8.69	1.22
	Meshkuj	27.75	8.07	7.17	1.10	7.50	1.52
	Total	30.77	8.02	7.58	1.08	8.12	1.49
Fshat	Femra	33.20	6.38	7.90	0.83	8.62	1.07
	Meshkuj	31.51	5.85	7.69	0.75	7.48	1.44
	Total	32.45	6.18	7.81	0.80	8.11	1.37

Tabela L-2 paraqet arritjet mesatare të nxënësve sipas profilit të shkollës së ndjekur, si dhe sipas llojit të shkollës publike apo private.

Tabela L-2


Lloji i shkollës	Profili i shkollës	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
TOTAL	Gjimnaz	27.71	8.42	7.16	1.16	7.18	1.72
	Gjuhët e Huaja dhe Seksioni 2 gjuhësh	28.78	7.98	7.32	1.07	7.14	1.49
	Artistike; Koreografike, Sportive	24.57	7.55	6.75	1.07	6.02	1.43
	Teknike profesionale	20.18	7.94	6.10	1.16	5.82	1.25
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	18.22	7.14	5.82	1.07	5.44	0.91
PUBLIK	Gjimnaz	27.17	8.39	7.09	1.16	7.02	1.71
	Gjuhët e Huaja dhe Seksioni 2 gjuhësh	28.78	7.99	7.32	1.08	7.14	1.50
	Artistike; Koreografike, Sportive	24.57	7.55	6.75	1.07	6.02	1.43
	Teknike profesionale	19.76	7.67	6.04	1.13	5.73	1.16
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	18.10	7.16	5.80	1.07	5.41	0.90
PRIVAT	Gjimnaz	31.04	7.87	7.62	1.05	8.17	1.46
	Gjuhët e Huaja dhe Seksioni 2 gjuhësh	-	-	-	-	-	-
	Artistike; Koreografike, Sportive	-	-	-	-	-	-
	Teknike profesionale	28.43	8.65	7.26	1.19	7.40	1.69
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	20.19	6.50	6.12	1.01	6.04	0.81

Bazuar në të dhënat e Tabelës L-2, për totalin e nxënësve dhe kategorinë publik rezulton se:

- nxënësit që ndjekin shkollat e Gjuhëve të Huaja dhe Seksioni 2-gjuhësh kanë rezultate më të larta kundrejt nxënësve të profileve të tjera, kjo si në provimin e Maturës 2016, po ashtu edhe në rezultatet Vjetore 2016.
- për sistemin privat nxënësit më të mirë rezultojnë të jenë nxënësit e shkollave të gjimnazit.

Tabela L-3

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave të Provimit të Maturës (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	0.80%	6.49%	13.65%	24.87%	26.50%	9.61%	0.92%
2	Gjuhëve të Huaja dhe Seksioni 2 gjuhësh	0.01%	0.08%	0.32%	0.77%	0.60%	0.33%	0.03%
3	Artistike; Koreografike, Sportive	0.02%	0.14%	0.28%	0.51%	0.28%	0.05%	0.00%
4	Teknike profesionale	0.58%	3.10%	3.47%	2.98%	1.22%	0.32%	0.03%
Në nivel kombëtar (dita)		1.40%	9.81%	17.72%	29.14%	28.60%	10.31%	0.99%
5	Gjimnaz -me kohë të shkurtuar	0.14%	0.69%	0.61%	0.46%	0.12%	0.02%	0.00%
Në nivel kombëtar		1.54%	10.50%	18.33%	29.59%	28.72%	10.33%	0.99%



Grafiku L-3


Tabela L-3, Tabela L-4, Grafiku L-3 e Grafiku L-4, japin shpërndarjen e notave (në përqindje) të provimit të maturës dhe notave vjetore për lëndën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe.

Në nivel kombëtar (dita), në provimin e maturës:

- kalueshmëria është 98.46%.
- nota me përqindjen më të lartë është **nota 7 me 29.14%**.
- notat 6, 7 dhe 8 kanë vlera në përqindje, shuma e të cilave përbën rreth 75% të totalit të nxënësve.
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e maturës është mjaft e ulët (0.99%).

Tabela L-4

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave Vjetore (në %)					
		5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	19.72%	12.74%	12.88%	13.66%	13.58%	10.74%
2	Gjuhëve të Huaja dhe Seksioni 2 gjuhësh	0.38%	0.43%	0.36%	0.51%	0.38%	0.13%
3	Artistike; Koreografike, Sportive	0.66%	0.27%	0.18%	0.10%	0.06%	0.05%
4	Teknike profesionale	6.11%	2.32%	1.31%	0.70%	0.49%	0.17%
Në nivel kombëtar (dita)		26.88%	15.76%	14.74%	14.98%	14.51%	11.09%
5	Gjimnaz –me kohë të shkurtuar	1.42%	0.36%	0.17%	0.08%	0.02%	0.00%
Në nivel kombëtar		28.29%	16.12%	14.90%	15.06%	14.54%	11.09%



Grafiku L-4

Arritjet vjetore të paraqitura në Tabelën L-4 tregojnë për një shpërndarje pothuajse uniforme mes notave 6, 7, 8 e 9, ku vlerat e përqindjeve të nxënësve të vlerësuar me ato nota janë pothuajse në vlera të përafërta. Shuma e tyre arrin në afërsisht 60% të totalit të nxënësve. Përqindja e lartë e nxënësve të vlerësuar me notën 10, e cila ka arritur vlerën prej 11.09% të nxënësve, tregon se diferenca mes numrit të nxënësve të vlerësuar me notën 9 kundrejt atyre me notën 10 është afërsisht 3% më shumë. Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 5 gjatë vitit shkollor arrin vlerën prej rreth 26.88% të totalit të nxënësve.

Tabela L-5 dhe Tabela L-6 japin të dhëna mbi përqindjet e notave në nivel kombëtar sipas urbanizimit qytet/fshat dhe gjinisë femra/meshkuj për provimin e Maturës 2016 dhe arritjet Vjetore 2016.

I. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Tabela L-5 tregon se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Maturës është 0.99% e totalit të nxënësve, prej të cilëve:

- **0.03%** janë nxënës që i përkasin kategorisë fshat dhe **0.96%** i përkasin kategorisë qytet.

Ashtu siç u vu në dukje dhe më lart, rezultatet e arritura në Maturën 2016, si dhe ato Vjetore 2016 të nxënësve të qytetit janë më të larta kundrejt nxënësve të fshatit. Edhe pse në popullatën e individëve të kategorisë fshat kemi praninë e nxënësve, të cilët janë vlerësuar me nota të larta 9 e 10, duhet të vëmë në dukje se, numri i tyre është shumë i ulët kundrejt nxënësve të qytetit.

II. Arritjet sipas gjinisë femra/meshkuj

Përsëri, nga të dhënat e paraqitura në Tabelën L-6 dhe Grafikun L-6, rezulton se:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e maturës.

Por, nëse do të analizojmë popullatën e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë vitit shkollor, dhe treguesin e qëndrueshmërisë së rezultateve, vihet re se:

- qëndrueshmëria e arritjeve të nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë vitit shkollor është në nivele shumë të ulta.

Nëse do të krahasojmë nivelin e qëndrueshmërisë mes vajzave dhe djemve, të dhënat tregojnë dukshëm se **qëndrueshmëria është më e lartë tek djemtë**.

Nga të dhënat e Tabelës L-5 dhe Tabelës L-6, si dhe grafikëve përkatës, për Lëndën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë, rezulton se:

- Për kategorinë qytet, numri i nxënësve të vlerësuar me notën 4 në provimin e maturës është rreth 2 herë më i lartë kundrejt numrit të nxënësve të fshatit të vlerësuar me të njëjtën notë 4.
- Numri i nxënësve mbetet në provimin e maturës për kategorinë meshkuj është rreth 5.5 herë më i lartë krahasuar me kategorinë femra.
- Në notat 7, 8 e 9 të rezultateve të provimit të maturës, vihet re përqindja dominuese e kategorisë femra kundrejt kategorisë meshkuj.
- Niveli i qëndrueshmërisë së arritjeve (për notat 9 dhe 10) është më i lartë tek djemtë krahasuar me vajzat.

Përqindjet e notave në nivel kombëtar

Tabela L-5

Gjuhë shqipe


Matura 2016

Nota	Urbanizimi		Gjithsej
	Fshat	Qytet	
Nota 4	0.57%	0.97%	1.54%
Nota 5	4.14%	6.36%	10.50%
Nota 6	6.62%	11.71%	18.33%
Nota 7	8.31%	21.28%	29.59%
Nota 8	5.29%	23.43%	28.72%
Nota 9	1.04%	9.29%	10.33%
Nota 10	0.03%	0.96%	0.99%


Vjetore 2016

Nota	Urbanizimi		Gjithsej
	Fshat	Qytet	
Nota 4	0.00%	0.00%	0.00%
Nota 5	9.16%	19.13%	28.29%
Nota 6	4.25%	11.87%	16.12%
Nota 7	3.23%	11.67%	14.90%
Nota 8	3.05%	12.01%	15.06%
Nota 9	2.77%	11.77%	14.54%
Nota 10	1.65%	9.44%	11.09%

Përqindjet e notave sipas urbanizimit
Matura 2016



Përqindjet e notave sipas urbanizimit
Vjetore 2016




Përqindjet e notave në nivel kombëtar

Tabela L-6

Gjuhë shqipe


Matura 2016

Nota	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
Nota 4	0.28%	1.26%	1.54%
Nota 5	2.23%	8.27%	10.50%
Nota 6	6.11%	12.22%	18.33%
Nota 7	15.62%	13.98%	29.59%
Nota 8	19.77%	8.95%	28.72%
Nota 9	8.25%	2.08%	10.33%
Nota 10	0.84%	0.15%	0.99%

Përqindjet e notave sipas gjinisë
Matura 2016


Vjetore 2016

Nota	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
Nota 4	0.00%	0.00%	0.00%
Nota 5	5.45%	22.84%	28.29%
Nota 6	8.04%	8.08%	16.12%
Nota 7	9.36%	5.55%	14.90%
Nota 8	10.52%	4.54%	15.06%
Nota 9	11.11%	3.43%	14.54%
Nota 10	8.91%	2.17%	11.09%

Përqindjet e notave sipas gjinisë
Vjetore 2016


Nga të dhënat e analizuara më lart, rezulton se, arritjet e nxënësve në provimin e Maturës 2016 karakterizohen nga *“paqëndrueshmëria”* duke i krahasuar ato me arritjeve Vjetore 2016. Tabela L-7 jep informacion mbi nivelin e paqëndrueshmërisë së rezultateve Vjetore 2016 (për të cilat nxënësit janë vlerësuar gjatë gjithë vitit shkollor 2015-2016), të krahasuara me rezultatet e marra në provimin e Maturës 2016, për lëndën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe.

Tabela L-7

Notat vjetore (në %)		Notat e Provimit të Maturës (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
pa notë	2.92%	0.09%	0.59%	0.78%	0.88%	0.45%	0.12%	0.01%
5	27.47%	1.25%	7.69%	10.18%	7.08%	1.21%	0.05%	0.00%
6	15.65%	0.16%	1.55%	4.18%	6.98%	2.58%	0.20%	0.000%
7	14.47%	0.03%	0.46%	2.04%	6.51%	4.80%	0.61%	0.00%
8	14.62%	0.00%	0.16%	0.80%	4.55%	7.34%	1.71%	0.06%
9	14.11%	0.005%	0.04%	0.28%	2.71%	7.61%	3.24%	0.23%
10	10.76%	0.00%	0.01%	0.06%	0.87%	4.73%	4.40%	0.69%
Gjithsej	100.00%	1.54%	10.50%	18.33%	29.60%	28.72%	10.32%	0.99%

Tabela L-7 lexohet si më poshtë:

- ❖ Nga rreshti i parafundit i tabelës, lexojmë se, nga totali i nxënësve të vlerësuar gjatë vitit shkollor, vetëm 10.76% e tyre kanë marrë notën 10, në Lëndën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë, ndërkohë që nxënësit që edhe në provimin e Maturës e kanë ruajtur vlerësimin me notën 10 është 0.69% e totalit të nxënësve.
- ❖ Nëse rezultatet e nxënësve do të ishin të qëndrueshme, atëherë në provimin e maturës, duhet të rezultonin 10.76% nota 10 në nivel kombëtar. Ndërkohë, që ka ndodhur që nxënës të vlerësuar me 10 në procesin mësimor vjetor, në provimin e maturës janë vlerësuar me notën 5 (0.01%), notën 6 (0.06%), notën 7 (0.87%), notën 8 (4.73%), notën 9 (4.40%) dhe nota 10 (0.69%).
- ❖ Këto shifra tregojnë se, nxënësit e vlerësuar me notën 10 gjatë vitit shkollor, në provimin e maturës janë vlerësuar edhe me nota 5, 6, 7, 8 apo 9. Pra, ka nxënës, vlerësimi i të cilëve është ulur me 2-3 nota, madje edhe me 4-5 nota.

Të dhënat e Tabelës L-7 tregojnë se, një përqindje e caktuar e nxënësve, të cilët janë vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 5 e 6, në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 7, 8 e 9.

Nga 27.47% e nxënësve që gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 5, vetëm 7.69% e tyre kanë mbajtur po atë notë në provimin e maturës. Ndërsa, ka prej tyre, që në provimin e maturës kanë marrë edhe vlerësime me mbi 2, 3 apo më shumë nota. (Kategoria *“pa notë vjetore”* prej 2.92% tregon se në databazën e AKP për ta nuk ka notë vjetore, pasi lënda e tyre mund të mos jetë lëndë mësimore në maturë.)

Dukuria e *paqëndrueshmërisë së njohurive* lidhet me shkallën e fiktivitetit në shkollë, ndërsa dukuria e vlerësimit me 2-3 nota më lart në provimin e maturës tregon për *nivel të ulët të monitorimit të mjediseve të provimit*.

Tabelat më poshtë L-8 dhe L-8/1 tregojnë për çdo DAR/ZA, rastet e diferencave me tre dhe katër nota, midis notës vjetore dhe notës së maturës:

Tabela L-8

Dar/Za	Numri i rasteve nv - nm (+3)
TIRANË	28
DURRËS	16
VLORE	10
KORÇË	8
SHKODËR	6
KAMËZ	5
KUKËS	5
ELBASAN	4
KAVAJË	4
KRUJË	4
LIBRAZHD	4
TIRANË QARK	4
TROPOJË	4
DIBËR	3
POGRADEC	3
SARANDË	3
FIER	2
GRAMSH	2
KUÇOVË	2
PËRMET	2
SKRAPAR	2
BERAT	1
GJIROKASTËR	1
HAS	1
KURBIN	1
LEZHË	1
LUSHNJE	1
MALLAKASTËR	1
PUKË	1
GJIROKASTËR	1
MALËSI E MADHE	1
MALLAKASTËR	1
PUKË	1

Tabela L-8/1


Dar/Za	Numri i rasteve nv - nm (+4)
DIBËR	1
FIER	1
PËRMET	1
SKRAPAR	1
VLORE	2

2) Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe

Grafiku L-8 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e maturës në lëndën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe 2016. Grafiku tregon se kemi një shpërndarje pothuajse normale të arritjeve të nxënësve në provimin e maturës.

Grafiku L-8

Shpërndarja LETERSI DHE GJUHE SHQIPE - 2016




Grafiku L-9 paraqet shpërndarjen kumulative të pikëve të fituara në provimin e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe në Maturën 2016.

Grafiku L-9 tregon se:

- në intervalin 46-50 pikë ndodhen rezultatet e 0.36% të totalit të nxënësve;
- 0.33% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 5 pikë;
- 30.37% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 21 pikë;
- 59.97% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 29 pikë;
- 99.64% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 45 pikë.

Grafiku L-9



Nisur nga rezultatet e marra në testin e gjuhës shqipe dhe letërsisë, nxënësit shfaqin kompetenca në nivelin:

Shumë mirë:

- identifikon llojin e tekstit jo letrar;
- dallon faktin nga opinion;
- lokalizon informacionin që përmbush disa kushte;
- identifikon një ide, një marrëdhënie apo shpjegon kuptimin e një fjale apo fraze;
- zbulon kuptimin me të cilin del fjala, në kontekstin që ajo përdoret;
- identifikon karakteristika përmbajtjesore të teksteve;
- identifikon përdorimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve apo shprehjeve;
- identifikon elemente të stilit të një shkrimtari të shfaqura në një fragment të dhënë;
- shpjegon funksionin e kontrastit në një fragment.

Mjaftueshëm:

- identifikimin e tezës së një teksti argumentues;
- identifikon argumentet në mbështetje të një teze;
- sintetizon përmbajtjen nga burime të ndryshme;
- lokalizon dhe organizon informacionin;
- identifikon motivet në një vepër;
- analizon marrëdhëniet midis personazheve në një pjesë, nisur nga ajo çfarë thonë apo veprojnë.

Dobët:

- analizon mënyrën si një pjesë letrare lidhet më tema apo çështje të caktuara;
- zgjeron idetë e dhëna, përmes një analize dhe vlerësimi origjinal;
- interpreton dhe vlerëson ndikimin e detajeve, veprimeve të personazheve etj, në pjesën e dhënë;
- komenton se si gjuha krijon efekte të caktuara në një tekst letrar;
- zbulon se si përdorimi i fjalëve të autorit krijon tonin dhe atmosferën e përgjithshme të veprës.

Ndër faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e nxënësve në provimin e maturës për lëndën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë janë:

- ❖ familjarizimi i nxënësve me metodën e testimit me shkrim të njohurive, bazuar në kurrikulën kombëtare, e cila ka ardhur edhe si pasojë e publikimit të testeve dhe zgjidhjeve në faqen e web të AKP, si dhe përdorimi i pyetjeve të ndryshme të testeve të AKP gjatë procesit mësimor nga ana e mësuesve - kjo si pjesë e përgatitjes për provimet dalëse;
- ❖ aplikimi i metodës së korrigjimit të testeve bazuar në 2 vlerësime të pavarura nga njëri-tjetri;
- ❖ nivele të ndryshme të cilësisë në mësimdhënie gjatë procesit mësimor, kjo më e dallueshme mes qytetit dhe fshatit, si dhe mes sistemit publik dhe atij privat;
- ❖ nivele të ndryshme të cilësisë dhe kualifikimit të mësuesve në nivel kombëtar, por edhe mes sistemit privat dhe atij publik, qytetit dhe fshatit;
- ❖ shkalla e faktorëve motivues të mësuesve gjatë procesit mësimor;
- ❖ cilësia e teksteve bazë për nxënësit;
- ❖ mësimdhënia e bazuar në disa tekste bazë për nxënësit;
- ❖ fiktiviteti në vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor;
- ❖ administrimi i mjediseve ku është zhvilluar provimi i maturës;
- ❖ niveli social – ekonomik i familjeve dhe komuniteteve përkatëse ku jetojnë nxënësit.

3) Arritjet e nxënësve në Letërsi dhe Gjuhë Shqipe - statistika krahasuese

Tabela L-10 jep informacion mbi mesataren e pikëve të fituara në test dhe shmangien mesatare, notën mesatare në provimin e maturës dhe shmangien mesatare, si dhe notën mesatare vjetore dhe shmangien mesatare, në nivel DAR/ZA. Ndërkohë, mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit në nivel kombëtar është 26.62 pikë, nota mesatare vjetore në nivel kombëtar është 6.98, ndërsa nota mesatare e maturës në nivel kombëtar është 7.01.

Të dhënat e Tabelës L-10 tregojnë se:

- 8 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **mbi** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar (Durrës, Kavajë, Kolonjë, Kurbin, Përmet, Sarandë, Shkodër, Tiranë Bashki, Vlorë),
- 6 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **relativisht nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar,
- 24 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **ndjeshëm nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar (Malësi e Madhe, Tepelenë, Bulqizë, Delvinë).

Tabela L-11 jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e maturës në nivel DAR/ZA e nivel kombëtar, notën mesatare në provimin e maturës, notën mesatare vjetore, si dhe diferenca (NM-NV).

Të dhënat e tabelës L-11 tregojnë se:

- 22 DAR/ZA kanë arritje në provimin e maturës më të larta se arritjet vjetore. Këtu përmendim ZA Pukë, ku arritjet mesatare të nxënësve kanë një rritje në provimin e maturës me 0.48 njësi notë krahasuar me arritjet mesatare vjetore. Më pas, renditen DAR/ZA: Skrapar, Dibër, Durrës, Korçë, Krujë, Përmet, etj.
- ZA Tepelenë ka arritje mesatare të nxënësve në provimin e maturës me -0.89 njësi note krahasuar me arritjet mesatare vjetore. Në vazhdim, përmendim DAR/ZA Berat, Bulqizë, Has, Gjirokastrë, Mallakastrë, Lushnjë, etj.

Tabela L-12 dhe Tabela L-13 japin informacion statistikor në nivel DAR. Shihet që, DAR Tirana Qark e DAR Vlorë kanë diferencën më të madhe mes notës së maturës dhe notës vjetore, rreth 0.22 njësi note.

Tabela L-14 e Tabela L-16 japin informacion mbi notën mesatare në provimin e maturës në nivel DAR/ZA dhe DAR, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjuhët e huaja dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.

Nivelet më të ulta të arritjeve mesatare në provimin e maturës i përkasin nxënësve të gjimnazit më kohë të shkurtuar. 11 DAR/ZA kanë notë mesatare mature më të lartë se nota mesatare e maturës në nivel kombëtar.

Tabela L-15 dhe Tabela L-17 japin informacion mbi notën mesatare vjetore në nivel DAR dhe DAR/ZA, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjuhët e huaja dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.

Ashtu si për notën mesatare në provimin e maturës, edhe për notën mesatare vjetore, nxënësit e gjimnazit me kohë të shkurtuar kanë përgjithësisht arritje më të ulta krahasuar me nxënësit e shkollave të profileve të tjera. 16 DAR/ZA kanë notë mesatare vjetore më të lartë se nota mesatare vjetore në nivel kombëtar.

Nr.	DAR/ZA	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
1	Berat	23.83	8.55	6.62	1.22	6.84	1.77
2	Bulqizë	22.86	8.60	6.48	1.23	6.62	1.72
3	Delvinë	23.68	7.66	6.62	1.08	6.55	1.75
4	Devoll	25.52	7.64	6.87	1.07	6.60	1.81
5	Dibër	25.21	8.00	6.83	1.12	6.77	1.63
6	Durrës	28.35	8.86	7.25	1.21	7.01	1.73
7	Elbasan	25.65	8.37	6.88	1.17	6.92	1.78
8	Fier	26.16	8.82	6.95	1.23	7.19	1.75
9	Gramsh	23.79	7.65	6.63	1.09	6.95	1.77
10	Gjirokastrë	24.66	9.05	6.73	1.28	7.02	1.71
11	Has	23.74	6.84	6.64	0.96	7.42	1.82
12	Kamzë	25.58	7.97	6.87	1.12	6.51	1.48
13	Kavajë	27.37	7.92	7.12	1.10	7.03	1.71
14	Kolonjë	27.49	9.08	7.12	1.25	7.40	1.99
15	Korçë	26.08	9.79	6.91	1.38	6.68	1.67
16	Krujë	24.20	8.85	6.67	1.26	6.56	1.80
17	Kuçovë	23.45	9.80	6.56	1.38	6.88	1.69
18	Kukës	26.70	7.61	7.04	1.04	7.01	1.81
19	Kurbin	27.15	8.11	7.09	1.11	7.05	1.79
20	Lezhë	25.74	7.91	6.89	1.11	7.14	1.79
21	Librazhd	25.59	8.50	6.87	1.19	7.09	1.72
22	Lushnjë	24.79	8.04	6.76	1.13	6.98	1.74
23	Malësi e Madhe	21.33	7.40	6.27	1.09	6.24	1.60
24	Mallakastër	26.42	7.32	7.00	1.01	7.04	1.87
25	Mat	24.89	8.39	6.77	1.18	6.75	1.70
26	Mirditë	23.12	9.29	6.51	1.32	6.35	1.71
27	Peqin	23.14	7.06	6.55	1.00	6.77	1.73
28	Përmet	27.69	8.72	7.16	1.20	6.75	1.82
29	Pogradec	25.61	8.66	6.87	1.21	6.79	1.70
30	Pukë	26.95	8.38	7.06	1.16	6.58	1.59
31	Sarandë	27.38	8.67	7.11	1.20	7.09	1.80
32	Skrapar	26.33	9.28	6.95	1.32	6.49	1.71
33	Shkodër	27.30	9.20	7.10	1.27	6.91	1.61
34	Tepelenë	22.90	7.41	6.51	1.07	7.40	2.07
35	Tiranë bashki	29.83	8.26	7.45	1.12	7.38	1.68
36	Tiranë Qark	24.52	8.41	6.72	1.19	6.58	1.62
37	Tropojë	24.76	8.61	6.76	1.20	6.99	1.82
38	Vlorë	28.16	9.20	7.21	1.27	6.91	1.70

Nr.	DAR/ZA	Kalueshmëria në provimin e Maturës	Nota Mesatare e Maturës (NM)	Nota Mesatare Vjetore (NV)	Diferenca e Notës së Maturës me Vjetoren NM-NV
1	Berat	97.25%	6.62	6.84	-0.22
2	Bulqizë	96.63%	6.48	6.62	-0.14
3	Delvinë	99.09%	6.62	6.55	0.06
4	Devoll	99.24%	6.87	6.60	0.27
5	Dibër	98.54%	6.83	6.77	0.06
6	Durrës	99.32%	7.25	7.01	0.23
7	Elbasan	98.94%	6.88	6.92	-0.04
8	Fier	98.14%	6.95	7.19	-0.24
9	Gramsh	98.30%	6.63	6.95	-0.32
10	Gjirokastrë	94.62%	6.73	7.02	-0.28
11	Has	99.13%	6.64	7.42	-0.78
12	Kamzë	98.59%	6.87	6.51	0.36
13	Kavajë	98.35%	7.12	7.03	0.09
14	Kolonjë	98.56%	7.12	7.40	-0.28
15	Korçë	96.08%	6.91	6.68	0.23
16	Krujë	96.04%	6.67	6.56	0.11
17	Kuçovë	92.38%	6.56	6.88	-0.32
18	Kukës	99.72%	7.04	7.01	0.03
19	Kurbin	99.56%	7.09	7.05	0.04
20	Lezhë	99.33%	6.89	7.14	-0.24
21	Librazhd	97.94%	6.87	7.09	-0.23
22	Lushnjë	98.80%	6.76	6.98	-0.21
23	Malësi e Madhe	96.56%	6.27	6.24	0.03
24	Mallakastër	99.38%	7.00	7.04	-0.04
25	Mat	98.53%	6.77	6.75	0.02
26	Mirditë	96.77%	6.51	6.35	0.16
27	Peqin	99.58%	6.55	6.77	-0.22
28	Përmet	99.02%	7.16	6.75	0.41
29	Pogradec	97.67%	6.87	6.79	0.09
30	Pukë	99.59%	7.06	6.58	0.48
31	Sarandë	98.61%	7.11	7.09	0.02
32	Skrapar	97.93%	6.95	6.49	0.46
33	Shkodër	98.80%	7.10	6.91	0.19
34	Tepelenë	97.93%	6.51	7.40	-0.89
35	Tiranë bashki	99.43%	7.45	7.38	0.07
36	Tiranë Qark	98.29%	6.72	6.58	0.14
37	Tropojë	96.33%	6.76	6.99	-0.23
38	Vlorë	98.69%	7.21	6.91	0.30
Republika		98.46%	7.01	6.98	0.03

Nr.	DAR	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
1	Berat	24.05	8.94	6.64	1.27	6.81	1.75
2	Dibër	24.61	8.31	6.74	1.17	6.73	1.67
3	Durrës	27.43	9.02	7.12	1.25	6.91	1.76
4	Elbasan	25.32	8.30	6.83	1.16	6.96	1.76
5	Fier	25.64	8.43	6.88	1.18	7.09	1.76
6	Gjirokastrë	24.88	8.72	6.77	1.23	7.06	1.85
7	Korçë	25.94	9.20	6.91	1.29	6.74	1.72
8	Kukës	25.68	7.82	6.90	1.08	7.08	1.82
9	Lezhë	25.82	8.33	6.90	1.16	7.08	1.79
10	Shkodër	26.61	9.14	7.00	1.27	6.81	1.62
11	Tiranë Bashki	29.83	8.26	7.45	1.12	7.38	1.68
12	Tiranë Qark	25.59	8.18	6.87	1.15	6.65	1.60
13	Vlorë	27.77	9.06	7.16	1.25	6.94	1.72

Tabela L-13

Nr.	DAR	Kalueshmëria në provimin e Maturës	Nota Mesatare e Maturës (NM)	Nota Mesatare Vjetore (NV)	Diferenca e Notës së Maturës me Vjetoren NM-NV
1	Berat	96.36%	6.64	6.81	-0.16
2	Dibër	98.14%	6.74	6.73	0.00
3	Durrës	98.59%	7.12	6.91	0.21
4	Elbasan	98.70%	6.83	6.96	-0.13
5	Fier	98.50%	6.88	7.09	-0.21
6	Gjirokastrë	96.52%	6.77	7.06	-0.29
7	Korçë	97.04%	6.91	6.74	0.16
8	Kukës	98.79%	6.90	7.08	-0.19
9	Lezhë	99.00%	6.90	7.08	-0.18
10	Shkodër	98.62%	7.00	6.81	0.20
11	Tiranë Bashki	99.43%	7.45	7.38	0.07
12	Tiranë Qark	98.43%	6.87	6.65	0.22
13	Vlorë	98.69%	7.16	6.94	0.22

RAPORT PUBLIK – MATURA SHTETËRORE 2016

Tabela L-14

Nr.	DAR/ZA	Gjimnazi	Gjuhët e huaja & Seksioni 2 gjuhësh	Artistike, Koreografike, Sportive	Teknike Profesionale	Gjimnaz- me kohe të shkurtuar	LËNDA: LETËRSI DHE GJUHE SHQIPE		
		Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare e Maturës		Diferenca (NM-NMk)
		(NM)	(NM)	(NM)	(NM)	(NM)	(NM)	(NMk)	
1	Berat	6.87	5.79	6.53	5.54	5.34	6.62	7.01	-0.39
2	Bulqizë	6.48			6.14		6.48	7.01	-0.53
3	Delvinë	6.78					6.62	7.01	-0.39
4	Devoll	6.87					6.87	7.01	-0.14
5	Dibër	6.89					6.83	7.01	-0.18
6	Durrës	7.49	7.05	6.65	6.19	5.75	7.25	7.01	0.24
7	Elbasan	7.12	6.68	6.67	5.92	6.16	6.88	7.01	-0.13
8	Fier	7.06		6.64	5.99	6.26	6.95	7.01	-0.06
9	Gramsh	6.63					6.63	7.01	-0.38
10	Gjirokastrër	7.08	6.65	5.87	5.15	5.61	6.73	7.01	-0.28
11	Has	6.64			6.30	6.08	6.64	7.01	-0.37
12	Kamzë	7.06					6.87	7.01	-0.14
13	Kavajë	7.37					7.12	7.01	0.11
14	Kolonjë	7.12					7.12	7.01	0.11
15	Korçë	7.38	7.88	6.19	5.59	5.15	6.91	7.01	-0.10
16	Krujë	6.79			5.00	4.94	6.67	7.01	-0.34
17	Kuçovë	6.83				5.80	6.56	7.01	-0.45
18	Kukës	7.08					7.04	7.01	0.03
19	Kurbin	7.09					7.09	7.01	0.08
20	Lezhë	7.04	6.57			5.97	6.89	7.01	-0.12
21	Librazhd	6.96	6.50			6.87	7.01	-0.14	
22	Lushnjë	6.84				6.76	7.01	-0.25	
23	Malësi e Madhe	6.27				6.27	7.01	-0.74	
24	Mallakastër	7.01	5.17			7.00	7.01	-0.01	
25	Mat	6.77				6.77	7.01	-0.24	
26	Mirditë	6.76				6.51	7.01	-0.50	
27	Peqin	6.55				6.55	7.01	-0.46	
28	Përmet	7.16				7.16	7.01	0.15	
29	Pogradec	7.11				6.87	7.01	-0.14	
30	Pukë	7.06				7.06	7.01	0.05	
31	Sarandë	7.49				7.11	7.01	0.10	
32	Skrapar	7.45				7.11	7.01	0.10	
33	Shkodër	7.32	7.16	6.74	6.24	5.41	7.10	7.01	0.09
34	Tepelenë	6.51					6.51	7.01	-0.50
35	Tiranë bashki	7.64	7.51	6.91	6.78	6.24	7.45	7.01	0.44
36	Tiranë Qark	6.76				5.74	6.72	7.01	-0.29
37	Tropojë	6.85				5.18	6.76	7.01	-0.25
38	Vlorë	7.51				6.94	5.77	6.08	7.21

RAPORT PUBLIK – MATURA SHTETËRORE 2016

Tabela L-15

Nr.	DAR/ZA	Gjimnazi	Gjuhët e huaja & Seksioni 2 gjuhësh	Artistike, Koreografike, Sportive	Teknike Profesionale	Gjimnaz- me kohe të shkurtuar	LËNDA: LETËRSI DHE GJUHE SHQIPE		
		Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare Vjetore		Diferenca (NV-NV _k)
		(NV)	(NV)	(NV)	(NV)	(NV)	(NV)	(NV _k)	
1	Berat	7.10	6.62	6.68	5.29	5.19	6.84	6.98	-0.14
2	Bulqizë	6.62			7.22		6.62	6.98	-0.36
3	Delvinë	6.55					6.55	6.98	-0.43
4	Devoll	6.60					6.60	6.98	-0.38
5	Dibër	6.87			6.52	6.01	5.77	6.77	6.98
6	Durrës	7.40	8.40	5.52	5.43	5.70	7.01	6.98	0.03
7	Elbasan	7.27	6.15	6.28	5.35	5.42	6.92	6.98	-0.06
8	Fier	7.36		6.00	6.01	5.55	7.19	6.98	0.21
9	Gramsh	6.95					6.95	6.98	-0.03
10	Gjirokastrë	7.34	7.78	5.41	5.43	5.20	7.02	6.98	0.04
11	Has	7.42			5.81		7.42	6.98	0.44
12	Kamzë	6.74					6.51	6.98	-0.47
13	Kavajë	7.29		5.33	5.77	5.99	7.03	6.98	0.05
14	Kolonjë	7.40					7.40	6.98	0.42
15	Korçë	7.15	6.98	6.13	5.53	4.76	6.68	6.98	-0.30
16	Krujë	6.67			6.11	5.06	6.56	6.98	-0.42
17	Kuçovë	7.02					6.88	6.98	-0.10
18	Kukës	7.02				7.63	7.01	6.98	0.03
19	Kurbin	7.05					7.05	6.98	0.07
20	Lezhë	7.42	5.60		5.66	6.39	7.14	6.98	0.16
21	Librazhd	7.19	5.31		5.84	7.09	6.98	0.11	
22	Lushnjë	7.08	5.46			6.98	6.98	0.00	
23	Malësi e Madhe	6.24			5.00	6.24	6.98	-0.74	
24	Mallakastër	7.05				7.04	6.98	0.06	
25	Mat	6.75					6.75	6.98	-0.23
26	Mirditë	6.35	5.01		6.35		6.98	-0.63	
27	Peqin	6.77			6.77		6.98	-0.21	
28	Përmet	6.75			6.75		6.98	-0.23	
29	Pogradec	6.87	6.13		6.79		6.98	-0.19	
30	Pukë	6.58			6.58		6.98	-0.40	
31	Sarandë	7.69	5.33		7.09	6.98	0.11		
32	Skrapar	6.94	4.85		5.28	6.49	6.98	-0.49	
33	Shkodër	7.14	6.84	6.09	6.15	5.05	6.91	6.98	-0.07
34	Tepelenë	7.40					7.40	6.98	0.42
35	Tiranë bashki	7.67	7.58	6.28	6.39	5.44	7.38	6.98	0.40
36	Tiranë Qark	6.64				5.25	6.58	6.98	-0.40
37	Tropojë	7.09				5.13	6.99	6.98	0.01
38	Vlorë	7.30				5.83	5.07	5.05	6.91

RAPORT PUBLIK – MATURA SHTETËRORE 2016

Tabela L-16

Nr.	DAR	Gjimnazi	Gjuhët e huaja & Seksioni 2 gjuhësh	Artistike, Koreografike, Sportive	Teknike Profesionale	Gjimnaz- me kohë të shkurtuar	LËNDA: LETËRSI DHE GJUHE SHQIPE		
		Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare Vjetore		Diferenca (NM-NMk)
		(NM)	(NM)	(NM)	(NM)	(NM)	(NM)	(NMk)	
1	Berat	6.93	5.79	6.53	5.35	5.36	6.64	7.01	-0.37
2	Dibër	6.76	7.05		6.45	5.68	6.74	7.01	-0.27
3	Durrës	7.32	8.65	6.65	6.19	5.38	7.12	7.01	0.11
4	Elbasan	6.98	6.68	6.67	5.84	6.16	6.83	7.01	-0.18
5	Fier	6.97		6.64	5.89	6.23	6.88	7.01	-0.13
6	Gjirokastrë	6.92	6.65	5.87	5.15	5.61	6.77	7.01	-0.24
7	Korçë	7.20	7.88	6.19	5.47	5.15	6.91	7.01	-0.10
8	Kukës	6.94			6.21	5.40	6.90	7.01	-0.11
9	Lezhë	7.02	6.57		5.94	5.97	6.90	7.01	-0.11
10	Shkodër	7.15	7.16	6.74	6.24	5.41	7.00	7.01	-0.01
11	Tiranë Bashki	7.64	7.51	6.91	6.78	6.24	7.45	7.01	0.44
12	Tiranë Qark	7.00			6.21	5.89	6.87	7.01	-0.14
13	Vlorë	7.47		6.94	5.86	6.08	7.16	7.01	0.15


Tabela L-17

Nr.	DAR	Gjimnazi	Gjuhët e huaja & Seksioni 2 gjuhësh	Artistike, Koreografike, Sportive	Teknike Profesionale	Gjimnaz- me kohë të shkurtuar	LËNDA: LETËRSI DHE GJUHE SHQIPE		
		Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Nota Mesatare Vjetore		Diferenca (NV-NVk)
		(NV)	(NV)	(NV)	(NV)	(NV)	(NV)	(NVk)	
1	Berat	7.07	6.62	6.68	5.42	5.20	6.81	6.98	-0.17
2	Dibër	6.77	6.52		6.01	5.77	6.73	6.98	-0.25
3	Durrës	7.22	8.40	5.52	5.43	5.40	6.91	6.98	-0.07
4	Elbasan	7.17	6.15	6.28	5.35	5.42	6.96	6.98	-0.02
5	Fier	7.22		6.00	5.81	5.54	7.09	6.98	0.11
6	Gjirokastrë	7.20	7.78	5.41	5.43	5.20	7.06	6.98	0.08
7	Korçë	6.99	6.98	6.13	5.67	4.76	6.74	6.98	-0.24
8	Kukës	7.11			6.45	6.03	7.08	6.98	0.10
9	Lezhë	7.22	5.60		5.66	6.39	7.08	6.98	0.10
10	Shkodër	6.96	6.84	6.09	6.15	5.05	6.81	6.98	-0.17
11	Tiranë Bashki	7.67	7.58	6.28	6.39	5.44	7.38	6.98	0.40
12	Tiranë Qark	6.81			5.80	5.57	6.65	6.98	-0.33
13	Vlorë	7.35		5.83	5.16	5.05	6.94	6.98	-0.04

I. Lënda: Matematikë

1) Arritjet e Nxënësve

Grafikët e paraqitur në figurën e mëposhtme japin një informacion krahasues në nivel DAR/ZA të arritjeve të nxënësve në provimin e maturës dhe arritjeve vjetore për lëndën e Matematikës. Grafikët e dhënë tregojnë përqindjet e nxënësve, njohuritë e të cilëve ndodhen në intervalin “nën nivelin mesatar” dhe “mbi nivelin mesatar”. Niveli mesatar është marrë kufiri mes notës 7 e 8.



Në arritjet e maturës në nivel kombëtar, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar-nën nivelin mesatar” është 81.5% kundrejt 74.4% në arritjet vjetore. Ndërkohë, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar - mbi nivelin mesatar” është 18.5% për arritjet në provimin e maturës kundrejt 25.6% në arritjet vjetore. Figura tregon se, DAR/ZA Berat, Kolonjë, Tepelenë, Has, Kavajë, Sarandë kanë diferenca të theksuara mes arritjeve vjetore dhe arritjeve në provimin e maturës.

Tabela M – 1 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj**, dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

I. Në nivel kombëtar:

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e maturës në lëndën e Matematikës është **19.66 pikë**, me shmangie mesatare 10.52;
- **nota mesatare e maturës** është 5.98 me shmangie mesatare 1.51;
- **nota mesatare vjetore** është 6.30 me shmangie mesatare 1.73.

Pra, në nivel kombëtar, nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të maturës, rezulton se ndryshueshmëria është me 0.32 njësi note.

II. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën M-1, rezulton se:

- ekzistojnë diferenca të dukshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat.
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth 4.4 pikë më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.
- vlerat e shmangies mesatare për pikët e fituara në test për të dyja kategoritë, janë 10.94 për qytetin dhe 8.39 për fshatin.
